



DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

Shënim metodologjik mbi inflacionin bazë

Qëllimi i llogaritjes së inflacionit bazë

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), i llogaritur dhe i publikuar nga INSTAT-i, shërben për të matur **inflacionin total**. Banka e Shqipërisë synon arritjen e objektivit për inflacionin total në terma afatmesëm. Vlerat e inflacionit total mund të reflektojnë edhe veprimin e faktorëve me natyrë të përkohshme, afatshkurtër apo të goditjeve që ndodhin vetëm një herë dhe që shuhen me kalimin e kohës. Në këto raste, vlerat e inflacionit total nuk do të reflektonin vetëm ndikimin e faktorëve të qëndrueshëm që lidhen me kërkesën agregate dhe me ndikimin e politikës monetare, por edhe të faktorëve të ofertës dhe të pavarur nga politika monetare. Faktorët me natyrë të përkohshme në parim nuk duhet të influencojnë trendin e inflacionit dhe parashikimet afatmesme për të. Këta faktorë prekin komponentë të veçuar të indeksit të çmimeve të konsumit. Përrjashtimi i efekteve afatshkurtra, nuk do të thotë “injoinim” i tyre në analizat e vlerave aktuale të inflacionit, por njohje më e plotë e natyrës së presioneve të inflacionit dhe të vetë procesit të formimit të inflacionit në një ekonomi.

Inflacioni i vlerësuar pa ndikimet nga luhatjet afatshkurtra, goditjet njëherëshe dhe ato të ofertës quhet **inflacion bazë**. Ai përfaqëson pjesën më të qëndrueshme të inflacionit, të ndikuar nga politika monetare dhe nga faktorët e kërkesës. Ai përdoret gjerësisht për qëllime analize dhe vendimmarrjeje të politikës monetare. Në parim, matjet e inflacionit bazë konvergojnë në trendin afatgjatë të inflacionit.

Bankat qendrore, për qëllime të analizave dhe të vendimmarrjes, zhvillojnë matje të ndryshme të inflacionit bazë. Një nga më të përhapurat, më të thjeshtat në zbatim, me transparencë relativisht të lartë është ajo me përjashtim të përhershëm. Kjo përjasje nënkupton përjashtimin e



DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

përhershëm të disa artikujve të shportës, çmimet e të cilëve paraqesin luhatshmëri të lartë në afat të shkurtër apo ndryshime që nuk varen nga politika monetare.

Llogaritja e inflacionit bazë në rastin e Shqipërisë

Për llogaritjen e inflacionit bazë, të dhënat bazë merren nga IÇK-ja e publikuar nga INSTAT-i, nga e cila përjashtohen artikujt e mëposhtëm:

- *Fruta dhe perime* – paraqesin sezonalitet të lartë dhe çmimet e tyre në treg shpesh reflektojnë goditje të ofertës;
- *Kafe, pije alkoolike, duhan* – mallra subjekt i akcizës;
- *Pagesat e energjisë elektrike; ujit të pijshëm; medikamente; shërbime spitalore* – zëra të shportës me çmime të rregulluara ose pothuajse të rregulluara;
- *Karburanti/nafta* - mall akcize dhe me çmim të ndikuar nga koniunkturat e tregjeve ndërkombëtare.

Me përjashtimin e këtyre artikujve, krijohet nënshporta e IÇK-së bazë, me anë të së cilës llogaritet inflacioni bazë si ndryshim vjetor, mujor apo tremujor. Pesha aktuale e nënshportës së IÇK-së bazë vlerësohet rreth 73.3%, ndërsa nënshporta e IÇK-së jobazë është 26.7%.

Këto pesha janë subjekt ndryshimi, në varësi të rishikimit vjetor të shportës së IÇK-së. Ndërkohë që, nëse ndonjë artikull del nga kategorizimet e dhëna më sipër, për shembull nga kategoria e artikujve me çmime të rregulluara, atëherë ai do të kalojë nga shporta jobazë në atë bazë. Për çdo ndryshim do të vendoset shënimi sqarues.